ALBANIAN-LANGUAGE EDUCATION AND THE PRESERVATION OF IDENTITY IN BORGO ERIZZO (1897–1912)

ARSIMI SHQIP DHE RUAJTJA E IDENTITETIT NË BORGO ERIZZO GJATË VITEVE 1897–1912

Bendis KRAJA

Abstract

Established between 1726 and 1733 by Albanian Catholic families who migrated from Shestan, Brisk, and the surrounding areas of Lake Shkodra, the community of Borgo Erizzo near Zadar preserved its Albanian vernacular and the memory of its ancestral homeland across generations. This paper examines efforts to introduce organized Albanian-language instruction between 1897 and 1912, when intergenerational transmission within families was supplemented by language courses, the work of teachers, and institutional support. Drawing on historical scholarship and the documentary evidence presented therein, the study explores how these initiatives expanded opportunities for literacy in Albanian and strengthened connections with Albanian cultural circles. Particular attention is devoted to the contributions of Pashk Bardhi and Anton Paluca, as well as to the relationship between the community's educational needs and Austro-Hungarian interests in the Adriatic. While support for Albanian-language instruction served the Monarchy's political objectives, it also provided the community with opportunities to cultivate its inherited language. In this context, the paper also considers the role of education in facilitating the transition from predominantly oral language preservation to its use in written forms. The study argues that these efforts reinforced a sense of Albanian ancestry without necessarily leading all members of the community towards shared political positions. The ancestral language could be maintained alongside integration into the host society, while cultural ties with Albania did not invariably translate into direct involvement in the Albanian national movement.

Keywords: Borgo Erizzo, Arbanasi, Albanian-language instruction, linguistic heritage, Austria-Hungary.

Abstrakt

I krijuar gjatë viteve 1726–1733 nga familje shqiptare katolike të shpërngulura nga Shestani, Brisku dhe viset përreth Liqenit të Shkodrës, komuniteti i Borgo Erizzo-s pranë Zarës ruajti për breza të folmen shqipe dhe kujtesën e vendit të origjinës. Ky punim shqyrton përpjekjet për mësimin e organizuar të shqipes gjatë viteve 1897–1912, kur transmetimit familjar iu shtuan kurset, puna e mësuesve dhe mbështetja institucionale. Duke u mbështetur në literaturën historike dhe në të dhënat dokumentare të paraqitura në të, studimi ndjek mënyrën se si këto nisma krijuan më shumë hapësirë për leximin, shkrimin dhe lidhjet me qarqet kulturore shqiptare. Vëmendje i kushtohet punës së Pashk Bardhit dhe Anton Palucës, si edhe marrëdhënieve ndërmjet nevojave të komunitetit dhe interesave austro-hungareze në Adriatik. Mbështetja për mësimin e shqipes u shërbente synimeve politike të Monarkisë, por u jepte edhe banorëve mundësi për të kultivuar gjuhën e trashëguar. Në këtë kuadër, shqyrtohet edhe roli i shkollimit në kalimin nga ruajtja kryesisht gojore e gjuhës drejt përdorimit të saj në forma të shkruara. Punimi argumenton se këto përpjekje ndihmuan në forcimin e lidhjes me prejardhjen shqiptare, pa i orientuar domosdoshmërisht të gjithë pjesëtarët e komunitetit drejt të njëjtave qëndrime politike. Gjuha e të parëve mund të ruhej krahas integrimit në shoqërinë vendase, ndërsa lidhja kulturore me Shqipërinë nuk shndërrohej gjithnjë në angazhim të drejtpërdrejtë në lëvizjen kombëtare.

Fjalë kyçe: Borgo Erizzo, Arbanasi, mësimi i shqipes, trashëgimia gjuhësore, Austro-Hungaria.

Hyrje

Komuniteti shqiptar i Borgo Erizzo-s u formua pranë Zarës në disa valë shpërnguljeje gjatë viteve 1726–1733. Familje katolike nga Shestani, Brisku dhe viset përreth Liqenit të Shkodrës u vendosën në këtë pjesë të Dalmacisë, atëherë nën sundimin venedikas. Rrethanat e vështira ekonomike dhe shoqërore, presioni fiskal, pasiguria dhe tensionet fetare e politike në territoret nën sundimin osman përbënin një nga faktorët kryesorë që nxitën largimin e një pjese të

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp93

popullsisë katolike drejt zotërimeve venedikase.[1] Vendosja e tyre u mbështet nga kryepeshkopi Vicko Zmajević dhe autoritetet venedikase, ndërsa vendbanimi mori emrin e administratorit Nicolò Erizzo. Banorët ndërtuan aty jetën e tyre të re, duke ruajtur të folmen, lidhjet farefisnore dhe kujtesën e prejardhjes shqiptare.[2] Historinë e vendosjes së tyre e trajtoi Tullio Erber në veprën e vitit 1883, të mbështetur në dokumentet e arkivit të administratës së kohës në Zarë.[3] Pothuajse dy shekuj më vonë, kjo trashëgimi u bë pikënisje për përpjekje të organizuara për mësimin e shqipes. Punimi ndalet te vitet 1897–1912 dhe shqyrton si iu shtuan transmetimit familjar kurset, mësuesit dhe mbështetja e autoriteteve. Analiza mbështetet në literaturën historike dhe në dokumentet e paraqitura në të; burimet arkivore përdoren kryesisht sipas këtyre botimeve. Roli i vecante që Austro-Hungaria luajti në nxitjen dhe mbështetjen e këtyre proceseve si dhe arsyet se përse e bëri këtë janë trajtuar në këtë punim.
Pyetja që udhëheq trajtimin është se çfarë ndryshoi në jetën gjuhësore të komunitetit kur shqipja, krahas përdorimit në familje, filloi të mësohej edhe në mënyrë të organizuar. Në qendër të analizës do të jenë përpjekjet për mësimin dhe kultivimin e gjuhës shqipe, veprimtaria kulturore dhe organizative, lidhjet me qarqet intelektuale shqiptare dhe, në veçanti, format e angazhimit të përfaqësuesve të Borgo Erizzo-s në momentet vendimtare të viteve 1912–1913. Në këtë mënyrë, rasti i Borgo Erizzo-s mund të lexohet jo vetëm si histori e mbijetesës së një komuniteti diasporik, por edhe si shembull i kalimit nga kujtesa e origjinës dhe identiteti kulturor drejt një forme më aktive të lidhjes me çështjen shqiptare.

Gjuha në familje dhe në jetën e komunitetit

Në Borgo Erizzo, të njohur edhe me emrin Arbanasi, shqipja u përcoll nga njëri brez te tjetri përmes përdorimit të saj në familje dhe marrëdhënieve të përditshme. Banimi pranë njëri-tjetrit dhe lidhjet farefisnore krijonin raste të vazhdueshme për përdorimin e saj. Fjalët e trashëguara, emërtimet dhe mënyrat e të shprehurit mbanin gjallë kujtesën e një vendi që brezat e rinj mund të mos e kishin njohur drejtpërdrejt. Kjo vazhdimësi ndihmon për të kuptuar pse nismat arsimore të fundit të shekullit XIX gjetën një gjuhë ende të pranishme në jetën e komunitetit.[4] Megjithatë, të flisje shqip në familje nuk do të thoshte domosdoshmërisht të dije ta lexoje dhe ta shkruaje. E folmja shërbente për nevojat e komunikimit të afërt, ndërsa shkollimi dhe jeta publike e lidhnin banorin me gjuhë të tjera. Këtu lindte edhe nevoja për mësim të organizuar: njohja e shqipes së shkruar mund të hapte rrugën drejt librave, letërkëmbimit dhe botimeve që qarkullonin jashtë vendbanimit. Kurset do t'i shtonin gjuhës së përdorur në shtëpi mundësi që transmetimi gojor, i vetëm, nuk i siguronte.
Banorët e Borgo Erizzo-s jetonin në një mjedis ku shqipja takohej me italishten dhe kroatishten. Njohja dhe përdorimi i tyre lidhej me shkollën, punën dhe pjesëmarrjen në jetën e Zarës. Këto marrëdhënie sillnin ndikime mbi të folmen, por nuk e zhduknin medoemos kujtesën e origjinës. Një pjesëtar i komunitetit mund të përdorte një gjuhë në familje dhe një tjetër në veprimtarinë publike. Për këtë arsye, historia e gjuhës duhet lexuar bashkë me përvojën e banorëve, pa e marrë çdo ndryshim gjuhësor si dëshmi të shkëputjes nga prejardhja.[5]

[1] Malaj, Edmond. "Rrethanat politiko-shoqërore të shpërnguljes së shqiptarëve në Zarë dhe krijimi i kolonisë së Borgo Erizzo-s". Studime Historike, nr. 1, 2024, f. 53–55. Për gjendjen e famullive të Briskut dhe Shestanit shih gjithashtu Peter Bartl dhe Injac Zamputi, *Vincenzo Zmajevich, Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë / Relazione dello stato d'Albania e Serbia (1702–1703)*, red. Albert Ramaj (Prishtinë–St. Gallen: Faik Konica–Albanisches Institut, 2022), f. 41–43.
[2] Malaj, Edmond. "Rrethanat politiko-shoqërore të shpërnguljes së shqiptarëve në Zarë dhe krijimi i kolonisë së Borgo Erizzo-s". Studime Historike, nr. 1, 2024, f. 53–82.
[3] Erber, Tullio. La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara. Cenni storici raccolti dai documenti dell'I. R. Archivio Luogotenenziale. Ragusa: G. Flori, 1883.
[4] Barančić, Maximiljana "Arbanasi i etnojezični identitet", *Croatica et Slavica Iadertina*, vol. 4, (2008), f. 551–568; Krisztián Csaplár-Degovics, "A dalmáciai Borgo Erizzo és az albán nemzetépítés. Az Osztrák–Magyar Monarchia új Albánia-politikája, 1896", *Világtörténet*, 10 (42), nr. 2 (2020), f. 209–210.
[5] Barančić, Maximiljana. "Arbanasi i etnojezični identitet". *Croatica et Slavica Iadertina*, vol.4, (2008), f. 551–568.

Lidhja ndërmjet gjuhës së trashëguar dhe përkatësive të ndryshme kulturore shfaqet edhe në shkrimin e Ernest Koliqit për Giacomo Vuxanin (Jak Vuxani). Figura e tij, u shfaq në fillim të shekullit XX si një prej përfaqësuesve më interesantë të Borgo Erizzo-s në raport me çështjen shqiptare. I lindur në vitin 1886 Vuxani u formua në mjedisin kulturor të Zarës dhe më pas ndoqi studimet juridike në Universitetin e Gracit. Figura e tij është domethënëse për karakterin kompleks të identitetit të komunitetit: ai ishte i lidhur me jetën politike dhe kulturore italiane të Zarës, por njëkohësisht ruante lidhjen me prejardhjen shqiptare, njihte shqipen dhe tregonte interes të vazhdueshëm për zhvillimet që lidhen me Shqipërinë. [6]
Ernest Koliqi, në shkrimin përkujtimor të botuar pas vdekjes së Vuxanit në revistën *Shêjzat* më 1964, e cilëson atë shprehimisht *"patriota Italo-albanese di Zara".*[7] Ky përcaktim është domethënës, sepse shpreh një identitet të dyfishtë që nuk perceptohej domosdoshmërisht si kundërshtues: lidhja me botën italiane të Dalmacisë bashkëjetonte me interesin për origjinën dhe çështjen shqiptare. [8] Në këtë aspekt, Vuxani mund të konsiderohet një ndërmjetës ndërmjet mjedisit të Borgo Erizzo-s, qarqeve italiane të Adriatikut dhe rrjeteve të diasporës shqiptare.
Hapja e kurseve solli një ndryshim të prekshëm në këtë jetë gjuhësore. Shqipja fitoi një vend edhe në orarin mësimor, në tekst dhe në punën e mësuesit. Familja mbetej hapësira ku fëmija e dëgjonte dhe e përdorte gjuhën, ndërsa kursi mund ta ndihmonte të njihej me shkrimin dhe me forma të tjera të saj. Marrëdhënia ndërmjet këtyre dy mënyrave të të mësuarit është e rëndësishme: mësimi i organizuar mbështetej te një trashëgimi e gjallë dhe, njëkohësisht, krijonte kushte për ta përcjellë atë më tej.

Kurset e shqipes dhe roli i mësuesve

Përpjekjet për mësimin e shqipes morën një drejtim më të qartë në vitin 1897. Sipas studiusit Hasan Bello, Dr.Ludovig von Thallóczy[9] i raportonte ministrit të Jashtëm austro-hungarez konstatimet e tij në terren. Mes të tjerash ai shkruante se banorët e kolonisë shqiptare të Borgo Erizzo-s komunikonin shqip dhe kishin një natyrë shumë të gjallë kombëtare.[10] Prej kohësh ata dëshironin dhe kërkonin një prift e një mësues shqiptar. H. Bello përmend shifrën 240 persona, por ajo kërkon kontroll në dokumentin origjinal për të përcaktuar se cilës pjesë të popullsisë i referohej. Dëshmia për kërkesën e mësuesit sugjeron se nevoja për mësim shqip shprehej edhe nga vetë komuniteti. Studimi i Csaplár-Degovics e lidh këtë periudhë me projektet për kurse, tekste dhe përgatitje mësuesish që Austro-Hungaria po bënte në vazhdën e politikës së saj për të ndikuar nga jashtë mbi lëvizjen kombëtare shqiptare.[11]
Konsulli i përgjithshëm në Shkodër Teodor Ippen e shihte me përparësi që mësuesit e kurseve të silleshin nga Shkodra. Përzgjedhja e tij fillestare ishin dy klerikët: franceskani Gjergj Fishta dhe jezuiti Ndre Mjeda të cilët edhe njihnin gjuhën kroate, edhe ishin të aftë dhe të përshtatshëm për të përmbushur çka u kërkohej. Por Ippen duke u konsultuar edhe me Urdhrin

[6] Ernest Koliqi, "Giacomo Vuxani, patriota Italo-albanese di Zara", *Shêjzat / Le Pleiadi*, Viti VIII, nr. 5–6 (maj–qershor 1964), f. 155–158. Shih gjithashtu: Giorgio Varisco (red.), *Borgo Erizzo. Scritti dedicati al quartiere albanese della città di Zara / Arbanasi. Napisi posvećeni albanskoj četvrti grada Zadra / Arbeneshi. Shkrimet kushtuar lagjes shqiptare në qytetin e Zarës*, *Atti e Memorie della Società Dalmata di Storia Patria*, vol. XLIV (Venezia: Società Dalmata di Storia Patria, 2022).
[7] Koliqi, Ernest. "Giacomo Vuxani...", f. 155–158. Për krijimin e Shoqatës Italo-Shqiptare në vitin 1910 dhe rolin e Vuxanit shih gjithashtu Varisco (red.), *Borgo Erizzo. Scritti dedicati al quartiere albanese della città di Zara*, Venezia, 2022.
[8] Koliqi, Ernest. "Giacomo Vuxani, patriota Italo-albanese di Zara", f. 155–158. Vetë titulli i shkrimit të Koliqit e përcakton Vuxanin si "patriot italo-shqiptar të Zarës".
[9] Historiani dhe nëpunësi i lartë shtetëror vlerësonin se popullsia që ruante një bashkësi gjuhësore të gjallë, me ndërhyrje të caktuar shtetërore mund të përfshihej në aksionet zyrtare të Monarkisë.
[10] Bello, Hasan. "Angazhimi i Austro-Hungarisë për librin e parë shqip të historisë së shqiptarëve". Telegrafi. https://telegrafi.com/angazhimi-austro-hungarise-per-librin-e-pare-ne-shqip-te-historise-se-shqiptareve/ (konsultuar më 1 nëntor 2026).
[11] Csaplár-Degovics, Krisztián. "A dalmáciai Borgo Erizzo és az albán nemzetépítés. Az Osztrák–Magyar Monarchia új Albánia-politikája, 1896". Világtörténet, 10 (42), nr. 2, 2020. Për të dhënat e kurseve, materialit bazë i referohen f. 210–215. Bello, Hasan. "Angazhimi i Austro-Hungarisë për librin e parë shqip të historisë së shqiptarëve". Telegrafi. https://telegrafi.com/angazhimi-austro-hungarise-per-librin-e-pare-ne-shqip-te-historise-se-shqiptareve/ (konsultuar më 1 nëntor 2026).

Françeskan në fund vendosi për Atin françeskan Pashk Bardhi[12]. Mësimi i organizuar filloi në shtator 1901[13], me Pashk Bardhin në një rol kryesor përgjegjes për mësimin ndërsa strukturat administrative merreshin me sigurimin e pagesës së mësuesit dhe të materialeve mësimore. Kurset përfshinin përgatitjen e personave që mund të jepnin mësim dhe shkollën e mbrëmjes për banorët. Ata u zhvilluan në ndërtesën e shkollës vendase.

Në grupin e parë të përgatitjes u regjistruan 14 persona, ndërsa mësimin e mbrëmjes e ndiqnin rreth 40 banorë. Mësimi i shqipes zhvillohej tri deri në katër orë në javë. Shifrat japin një ide për përmasat fillestare të punës, megjithëse nuk tregojnë sa prej pjesëmarrësve e përfunduan kursin ose sa përparuan në lexim e shkrim.[14]

Puna e mësuesit kërkonte të gjente një rrugë afrimi ndërmjet së folmes që banorët njihnin dhe gjuhës së shkruar të teksteve. Fjalët e dëgjuara në familje duhej të lidheshin me shkronjat, leximin dhe ushtrimet. Kjo nuk ishte thjesht çështje njohjeje të gjuhës nga mësuesi; kërkonte edhe vëmendje ndaj përvojës së nxënësve. Për të kuptuar më mirë si zhvillohej ky mësim, do të nevojiteshin tekste, programe dhe punime të pjesëmarrësve. Burimet e përdorura këtu japin më shumë të dhëna për organizimin sesa për atë që ndodhte gjatë orës mësimore.

Në vitin 1903, në mësimin e mbrëmjes u përfshinë edhe vajza të komunitetit, të cilave u ofroheshin tri orë shqip në javë, duke dëshmuar një zgjerim të bazës shoqërore të kësaj veprimtarie arsimore.[15] Kjo e dhënë meriton vëmendje sepse tregon se mundësia për të mësuar po zgjerohej përtej grupit të personave të përgatitur për mësimdhënie. Prania e vajzave hap një çështje të rëndësishme për historinë shoqërore të arsimit në Borgo Erizzo. Nëse gjuha shqipe ishte ruajtur për kaq vite kjo në radhë të pare ishte rrjedhojë e gjuhës që nanat, ato që kujdesishin e ishin present në shtëpi me fëmijët më gjatë, përdornin e u mëkonin. Megjithatë, të dhënat e njohura nuk lejojnë të përcaktohen numri i tyre, vijueshmëria ose ndikimi i mëvonshëm i shkollimit në jetën e tyre.[16]

Rëndësia e këtyre kurseve nuk qëndronte vetëm në përvetësimin e gjuhës së shkruar. Ato krijonin një kanal të ri komunikimi ndërmjet Borgo Erizzo-s dhe qarqeve kulturore shqiptare jashtë Dalmacisë. Që nga viti 1902, revista *Albania* e Faik Konicës, që botohej në Bruksel, filloi të përcillte informacione mbi zhvillimet në Borgo Erizzo.[17]

Në këtë mënyrë, një komunitet që për një kohë të gjatë kishte ruajtur identitetin e tij kryesisht nëpërmjet mekanizmave të brendshëm të trashëgimisë kulturore po lidhej gradualisht me rrjetet më të gjera të lëvizjes kulturore shqiptare.

Vlera e këtyre nismave qëndronte edhe te rregullsia që synonin të krijonin. Gjuha nuk i lihej vetëm rastit të bisedës familjare, por merrte kohë dhe vëmendje të posaçme. Për pjesëmarrësit, takimi me mësuesin dhe me tekstin mund të krijonte një marrëdhënie tjetër me shqipen: ajo që deri atëherë ishte kryesisht gjuhë e shtëpisë mund të bëhej edhe gjuhë leximi e letërkëmbimi. Ky ndryshim ndihmon për të kuptuar rëndësinë e kurseve pa u atribuar atyre rezultate që burimet nuk i dokumentojnë.

[12] Pashk Bardhi kishte studiuar në Bosnje-Hercegovinë si dhe kishte shërbyer si meshtar në ishullin e Korçulës. Ai konsiderohej si mësues këmbëngulës dhe I reptë. Detyrën e pranoi mbas hezitimit të pare dhe mbas plotësimit të kushtit që ai vetë të mos ishte nën vvarësi të guardianit françeskan të Zarës. Sipas: Csaplár-Degovics, Krisztián. "A dalmáciai Borgo Erizzo és az albán nemzetépítés. Az Osztrák–Magyar Monarchia új Albánia-politikája, 1896". Világtörténet, 10 (42), nr. 2, 2020, f.213.

[13] Mbas shumë negociatash u arrit organizimi i shkollës së re të mbrëmjes në Borgo Erizzo e cila ofronte kurse të gjuhës shqipe për popullsinë vendase dhe shërbente gjithashtu për përgatitjen e mësuesve të ardhshëm të gjuhës.

[14] Csaplár-Degovics, Krisztián. "A dalmáciai Borgo Erizzo és az albán nemzetépítés. Az Osztrák–Magyar Monarchia új Albánia-politikája, 1896". Világtörténet, 10 (42), nr. 2, 2020. Për të dhënat e kurseve, materialit bazë i referohen f. 210–215.

[15] Po aty, f. 215. Në vitin 1903 në mësimin e mbrëmjes u përfshinë edhe vajzat e Borgo Erizzo-s, me tri orë mësimi të shqipes në javë.

[16] Po aty, f.215.

[17] Po aty, f. 215. Autori evidenton gjithashtu se nga viti 1902 revista *Albania* e Faik Konicës përcillte rregullisht informacione lidhur me Borgo Erizzo-n dhe veprimtaritë e zhvilluara aty.

Mësimi i shqipes dhe mbështetja e autoriteteve

Eshtë me rëndesi të theksojmë që në fillim se Austro-Hungaria kishte arsye politike për ta mbështetur interesimin ndaj gjuhës dhe kulturës shqiptare. Interesat e saja gjeostrategjike, rivaliteti me Perandorinë Cariste Ruse dhe më pas me Italinë ishin shkak i këtij interesimi. Në kushtet e konkurrencës për ndikim në Adriatik dhe në Ballkan, marrëdhëniet kulturore mund të krijonin njohje, bashkëpunim dhe afërsi me qarqet shqiptare. Mbështetja e mësimit në Borgo Erizzo prej Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë duhet kuptuar brenda kësaj politike më të gjerë. Me shumë kujdes shqiptarët e kësaj kolonie, të përzgjedhur si më të përshtatshëm nga Vjena mes katër fshatrave me shqiptarë që ndodheshin në territorin e Monarkisë, mund të ktheheshin në një potencial të fuqishëm të aksionit politik që ishte planifikuar për shqiptarët. Aleati i vetëm i natyrshëm i Vjenës në Ballkan ishin shqiptarët. Megjithatë, synimet e Vjenës nuk e shpjegojnë të vetme kuptimin që kurset kishin për ata që i ndiqnin. Mundësia e krijuar nga politika shtetërore mund të përdorej nga komuniteti për të ruajtur gjuhën dhe për ta njohur më mirë atë.[18]

Vazhdimësia e mësimit të filluar më 1901 kërkonte mjete financiare. Dokumentet e vitit 1910, të trajtuara nga Fehari Ramadani[19], përmendin pagesa për mësuesin Anton Paluca. Sipas raportit që guvernatori austro-hungarez në Zarë i paraqiste Ministrisë së Jashtme e njoftonte se mësuesi i gjuhës shqipe A.Paluca kishte marrë 1000 korona që vinin nga kjo ministri.[20] Pas tetë muajsh Ministria e Jashtme kujdeset që krahas rrogës mujore prej 200 koronash t'i japë mësuesit Paluca edhe 1000 korana shtesë për një periudhë pesë mujore.[21]

Një shkresë e janarit 1912, e botuar në përmbledhjen e dokumenteve austro-hungareze për Shqipërinë, dëshmon gjithashtu interesimin administrativ për mësimin e shqipes. Të marra së bashku, këto të dhëna tregojnë se veprimtaria kishte nevojë për përkujdesje të vazhdueshme dhe se marrëdhënia me autoritetet shtrihej përtej hapjes së kurseve të para.[22]

Një gjurmë e drejtpërdrejtë e kësaj marrëdhënieje ruhet në katalogun gjermanisht të Arkivit Shtetëror Austriak. Në fondin e Ministrisë së Jashtme, brenda serisë për Shqipërinë, figuron njësia AT-OeStA/HHStA PA XIV 3, me titullin "Liasse I: Albanesische/albanische Sprachkurse in Borgo Erizzo", që mbulon vitet 1897–1906. Në shqip, titulli i referohet kurseve të gjuhës shqipe në Borgo Erizzo. Vendosja e dokumentacionit në këtë fond e lidh çështjen e kurseve me veprimtarinë e administratës së jashtme austro-hungareze. Katalogu vërteton ekzistencën dhe shtrirjen kohore të njësisë; ai nuk jep përmbajtjen e shkresave dhe nuk përdoret këtu si provë për hollësi të pakonsultuara.[23] Duhet përmendur fakti që kurse të gjuhës shqipe në Borgo Erizzo u përdorën nga autoritetet austro-hungareze edhe si mundësi trajnimi për ekspertet e tyre, civilë apo ushtarakë, që më pas silleshin në Shqipëri me detyra të ndryshme si konsuj apo specialist sektorësh të ndryshëm të cilet duke marrë njohuri të gjuhës shqipe e kishin më të lehtë më pas të vepronin në terren. Edhe kjo ishte pjesë e politikës së re që po ndiqej ndaj shqiptarëve.[24]

---

[18] Csaplár-Degovics, Krisztián. "Austro-Hungarian Colonial Ventures: The Case of Albania". The Hungarian Historical Review, 11, nr. 2, 2022, f. 267–304.

[19] Studiuesi dhe historian Fehari Ramadani ka botuar studimin e tij me titull "Qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj Lëvizjes kulturore shqiptare gjatë vitit 1910", Studime 19/2012, Prishtinë, 2013, f. 143–149.

[20] Ramadani, Fehari. "Qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj Lëvizjes kulturore shqiptare gjatë vitit 1910, Studime 19/2012, Prishtinë, 2013, f. 143149. I referohet: Arkivi i Institutit të Historisë Titanë, Vj.20-2-250. Raport nr.442/7, I guvernat. e mb. në Zarë, për MPJ.Mars 1910.

[21] Po aty, Vj.20-I-161. Njoftim nr.3085, i MPJ për guvernatorin p. dhe mb. në Zarë. Vjenë, 21 nëntor 1910.

[22] Ramadani, Fehari. "Qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj lëvizjes kulturore shqiptare gjatë vitit 1910". Studime, nr. 19/2012, Prishtinë, 2013, f. 143–149; Meta, Beqir dhe Sokol Gjermëni, përg. dhe red. Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912), vëll. I. Tiranë, 2014, dok. 68, f. 126–127.

[23] Österreichisches Staatsarchiv, Haus-, Hof- und Staatsarchiv. AT-OeStA/HHStA PA XIV 3. "Liasse I: Albanesische/albanische Sprachkurse in Borgo Erizzo", 1897–1906. Katalog arkivor në gjermanisht. https://archivinformationssystem.at/detail.aspx?ID=2221130 (konsultuar më 1 nëntor 2026).

[24] Csaplár-Degovics, Krisztián. "Austro-Hungarian Colonial Ventures: The Case of Albania". The Hungarian Historical Review, 11, nr. 2, 2022, f. 267–304.

Shkrimi i historianit Hasan Bellos e ndriçon këtë ndërthurje përmes propozimeve të Ludvig von Thallóczy-t dhe konsullit austro-hungarez në Shkodër, abanologut të njohur të kohës, Teodor Ippen-it. Ata i sugjeronin ministrit të jashtëm botimin e një gazetë shqipe dymujore në Zarë, që të paraqitej si nismë e shqiptarëve të Borgo Erizzo-s të lidhur me kombësi të tyre të vjetër.[25] Në drejtimin e saj parashikohej përfshirja e përfaqësuesve të dy rrymave rivale, italiane dhe kroate. Stefan Curani do të dërgohej nga Vjena për të përgatitur numrat e parë, gjithnjë nën mbikqyrjen e Vjenës, ndërsa sigurimi i materialeve mund të mbështetej nga konsullatat në Shkodër, Durrës dhe Prizren. Parashikoj edhe baza ortografike që do të duhej të përdorte gazeta çka do ishte sipas "Propozime lidhur me ortografinë shqiptare unike"[26] Propozimet përfshinin edhe përdorimin e një ortografie të përbashkët dhe bisedime me Faik Konicën që Albania të botohej në të dyja dialektet.

Kështu, mësimi, tekstet dhe shtypi mendoheshin si veprimtari që mund të mbështesnin njëra-tjetrën. Kjo dëshirë për organizim duhet dalluar nga lidhjet e dëshmuara më vonë: sipas Csaplár-Degovics, nga viti 1902 Albania pasqyronte lajme për Borgo Erizzo-n. Një projekt botimi dhe prania e komunitetit në një revistë ekzistuese janë dy të dhëna të ndryshme, edhe pse të dyja tregojnë vëmendjen ndaj komunikimit në shqip.[27]

Që të mos kishte vështirësi në daljen e gazetës, mëkëmbësia në Zarë porositej që të udhëzohej prej Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këto ishin propozime për organizimin e një veprimtarie botuese nën mbikëqyrjen e Vjenës; dëshmia nuk mjafton për të pohuar se gazeta doli ose se Curani e kreu këtë mision.

Përfundime

Në Borgo Erizzo, arsimi shqip nuk përfaqësoi fillimin e identitetit shqiptar, por një përpjekje për institucionalizimin e një trashëgimie gjuhësore që komuniteti e kishte ruajtur përmes mekanizmave të vet familjarë dhe kulturorë, në një moment kur kjo trashëgimi fitoi rëndësi të re në politikën austro-hungareze dhe në zhvillimet e çështjes shqiptare.

Historia e mësimit të gjuhës shqipe në Borgo Erizzo gjatë viteve 1897–1912 përfaqëson një rast të veçantë të ndërthurjes së përpjekjeve për ruajtjen e identitetit gjuhësor e kulturor të një komuniteti diasporik me politikat arsimore dhe interesat strategjike të Monarkisë Austro-Hungareze. Shqyrtimi i dokumentacionit dhe i literaturës historiografike tregon se institucionalizimi i mësimit të shqipes në fillim të shekullit XX nuk përbënte një dukuri të shkëputur nga historia e mëparshme e komunitetit, por një etapë të re në procesin e gjatë të ruajtjes dhe të ripërtëritjes së trashëgimisë së tij.

I formuar nga shpërnguljet e popullsisë shqiptare gjatë viteve 1726–1733, komuniteti i Borgo Erizzo-s kishte arritur të ruante për gati dy shekuj të folmen shqipe, traditat dhe kujtesën e prejardhjes, pavarësisht kontakteve të vazhdueshme me mjedisin gjuhësor e kulturor italian dhe kroat të Dalmacisë. Kjo vazhdimësi dëshmon se identiteti gjuhësor shqiptar nuk ishte produkt i ndërhyrjes austro-hungareze në fund të shekullit XIX. Ai kishte mbijetuar përmes mekanizmave të brendshëm të transmetimit familjar dhe komunitar, duke krijuar një bazë mbi të cilën mund të zhvilloheshin më vonë nismat për mësimin e organizuar të gjuhës.

Në këtë këndvështrim, periudha 1897–1912 shënon një ndryshim cilësor në historinë kulturore të Borgo Erizzo-s. Përpjekjet e nisura në fund të viteve 1890 dhe organizimi i rregullt i mësimit nga shtatori i vitit 1901 dëshmojnë kalimin e shqipes nga një gjuhë e trashëguar dhe e përdorur

[25] Bello, Hasan. "Angazhimi i Austro-Hungarisë për librin e parë shqip të historisë së shqiptarëve". Telegrafi. https://telegrafi.com/angazhimi-austro-hungarise-per-librin-e-pare-ne-shqip-te-historise-se-shqiptareve/ (konsultuar më 1 nëntor 2026).

[26] *" Propozime lidhur me ortografinë shqiptare unike"* ishte shtypur si dorëshkrim në Vjenë në janar të 1895-ës duke gjetur edhe dakortësinë e mbështetjen e disa letrarëve shqiptarë.

[27] Csaplár-Degovics, Krisztián. "A dalmáciai Borgo Erizzo és az albán nemzetépítés. Az Osztrák–Magyar Monarchia új Albánia-politikája, 1896". Világtörténet, 10 (42), nr. 2, 2020. Për të dhënat e kurseve, materialit bazë i referohen f. 210–215. Bello, Hasan. "Angazhimi i Austro-Hungarisë për librin e parë shqip të historisë së shqiptarëve". Telegrafi. https://telegrafi.com/angazhimi-austro-hungarise-per-librin-e-pare-ne-shqip-te-historise-se-shqiptareve/ (konsultuar më 1 nëntor 2026).

kryesisht në komunikimin e përditshëm drejt një gjuhe që filloi të mësohej edhe në forma të strukturuara arsimore. Krijimi i kurseve, sigurimi i mësuesve dhe i teksteve, përcaktimi i orëve mësimore dhe mbështetja financiare përbënin elemente të një procesi institucionalizimi, i cili i jepte gjuhës shqipe një funksion të ri në jetën e komunitetit.

Në këtë proces, roli i Monarkisë Austro-Hungareze ishte përcaktues në aspektin organizativ dhe financiar. Dokumentacioni i analizuar nga historiografia dëshmon se mbështetja e mësimit të shqipes në Borgo Erizzo ishte pjesë e politikës së re të Vjenës ndaj çështjes shqiptare, të konceptuar në vitin 1896. Përmes arsimit, përgatitjes së mësuesve dhe kultivimit të gjuhës, autoritetet austro-hungareze synonin të krijonin lidhje më të qëndrueshme me mjediset shqiptare dhe të forconin ndikimin e tyre politik e kulturor në hapësirën adriatike dhe ballkanike. Borgo Erizzo, për shkak të prejardhjes shqiptare të banorëve dhe pozitës së tij brenda Monarkisë, ofronte kushte të përshtatshme për realizimin e një pjese të këtyre objektivave.

Megjithatë, përfshirja e shkollës në politikën austro-hungareze nuk e shpjegon plotësisht rëndësinë që mësimi i shqipes mund të ketë pasur për vetë komunitetin. Pjesëmarrja e banorëve në kurse, regjistrimi i nxënësve në shkollën e mbrëmjes dhe zgjerimi i mësimit edhe për vajzat nga viti 1903 tregojnë se programi arsimor gjeti një bazë konkrete shoqërore. Këto të dhëna dëshmojnë interesim dhe pjesëmarrje, megjithëse nuk lejojnë të përcaktohet me saktësi shkalla në të cilën nisma buronte nga kërkesat e vetë banorëve apo nga nxitja e institucioneve shtetërore. Për rrjedhojë, mësimi i organizuar i shqipes duhet kuptuar si rezultat i ndërveprimit ndërmjet politikës institucionale dhe një mjedisi komunitar që kishte ruajtur gjuhën e origjinës.

Një rol të rëndësishëm në këtë zhvillim luajtën edhe mësuesit dhe klerikët shqiptarë, veçanërisht Pashk Bardhi dhe, në vitet e mëvonshme, veprimtaria e dokumentuar e Anton Palucës. Ata shërbyen si ndërmjetës ndërmjet institucioneve që mbështesnin arsimin dhe komunitetit që përfitonte prej tij. Veprimtaria e tyre nuk kufizohej vetëm në mësimdhënie, por lidhej edhe me sigurimin e materialeve shkollore, organizimin e kurseve dhe krijimin e kontakteve me mjediset kulturore shqiptare. Dokumentet e viteve 1910–1912 mbi pagesat e mësuesve dhe furnizimin me tekste dëshmojnë se kjo mbështetje vijoi edhe në prag të Pavarësisë së Shqipërisë.

Rëndësia e arsimit shqip në Borgo Erizzo duhet vlerësuar gjithashtu në raport me funksionin e dyfishtë që mori institucioni arsimor. Nga njëra anë, ai krijonte mundësi për kultivimin e gjuhës së origjinës nga banorët vendas; nga ana tjetër, shërbente për përgatitjen e mësuesve dhe për formimin gjuhësor të nëpunësve e oficerëve austro-hungarezë që do të angazhoheshin në çështjet shqiptare. Kjo veçori dëshmon se shkolla nuk ishte vetëm një institucion lokal për ruajtjen e gjuhës, por edhe pjesë e një rrjeti më të gjerë arsimor, diplomatik dhe kulturor. Pikërisht ndërthurja e këtyre funksioneve përbën një nga karakteristikat më domethënëse të përvojës së Borgo Erizzo-s.

Një përfundim tjetër lidhet me marrëdhënien ndërmjet ruajtjes së identitetit gjuhësor dhe formimit të vetëdijes kombëtare moderne. Këto dy procese, megjithëse të lidhura, nuk mund të trajtohen si të njëjta. Ruajtja e së folmes shqipe dhe e kujtesës së prejardhjes nuk nënkuptonte domosdoshmërisht identifikimin e të gjithë banorëve me programin politik të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Borgo Erizzo ishte pjesë e një mjedisi dalmat ku ndërthureshin ndikimet italiane, kroate dhe austro-hungareze. Për këtë arsye, identiteti i komunitetit kishte një karakter të shumëfishtë, ndërsa përkatësia gjuhësore shqiptare mund të bashkëjetonte me orientime të ndryshme kulturore dhe politike.

Në këtë kontekst, arsimi shqip mund të ketë ndikuar në forcimin e vetëdijes së prejardhjes dhe në zgjerimin e lidhjeve me botën shqiptare, por shkalla e këtij ndikimi nuk mund të matet vetëm përmes të dhënave mbi funksionimin e shkollës. Për të përcaktuar më saktë pasojat e mësimdhënies mbi përdorimin e gjuhës, marrëdhëniet ndërbreznore dhe vetëidentifikimin e banorëve, nevojitet një dokumentacion më i drejtpërdrejtë mbi përvojën e komunitetit. Ky

kufizim nuk e zvogëlon rëndësinë e nismës arsimore, por kërkon një dallim metodologjik ndërmjet objektivave të institucioneve, pjesëmarrjes së banorëve dhe rezultateve afatgjata të procesit.

Mësimi i organizuar i shqipes krijoi gjithashtu mundësi të reja komunikimi ndërmjet Borgo Erizzo-s dhe mjediseve intelektuale e kulturore shqiptare. Informacionet mbi shkollën dhe veprimtarinë e saj, të përcjella edhe nga revista *Albania* e Faik Konicës, tregojnë se komuniteti po bëhej pjesë e rrjeteve më të gjera të qarkullimit të ideve dhe të botimeve në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë, arsimi ndihmoi në krijimin e një lidhjeje të re ndërmjet trashëgimisë lokale dhe zhvillimeve kulturore shqiptare të kohës, duke i dhënë identitetit të ruajtur një dimension që kapërcente kufijtë e komunitetit.

Në prag të vitit 1912, ky proces ndërthurej me forma të tjera të organizimit kulturor dhe shoqëror. Krijimi i *Società Italo-Albanese* në vitin 1910 dhe veprimtaria e përfaqësuesve të saj dëshmojnë se një pjesë e elitës së Borgo Erizzo-s po artikulonte në mënyrë më të organizuar lidhjet me Shqipërinë dhe interesimin për çështjen kombëtare. Megjithatë, këto zhvillime nuk duhen interpretuar si pasojë e drejtpërdrejtë dhe e vetme e shkollimit në gjuhën shqipe. Ato përfaqësonin një proces më të gjerë, në të cilin ndërthureshin ruajtja e traditës, arsimi, rrjetet intelektuale dhe ndryshimet politike që po përjetonte hapësira shqiptare.

Në përfundim, përvoja e Borgo Erizzo-s gjatë viteve 1897–1912 dëshmon se ruajtja e identitetit gjuhësor në diasporë nuk ishte një proces statik, por një dukuri që merrte forma të reja në varësi të rrethanave historike. Mësimi i organizuar i shqipes nuk e zëvendësoi transmetimin tradicional të gjuhës, por krijoi një mekanizëm plotësues për kultivimin e saj dhe për zgjerimin e lidhjeve me botën shqiptare. Ndërhyrja austro-hungareze, megjithëse e udhëhequr nga interesa të përcaktuara politike e strategjike, krijoi kushte konkrete për institucionalizimin e kësaj trashëgimie gjuhësore.

Në këtë kuptim, rëndësia historike e Borgo Erizzo-s nuk qëndron vetëm te fakti se një komunitet shqiptar arriti ta ruante gjuhën e prejardhjes për gati dy shekuj, por edhe te mënyra se si kjo trashëgimi u përfshi në procese të reja arsimore dhe kulturore në kapërcyellin e shekujve XIX–XX. Përvoja e tij tregon se politikat shtetërore dhe nevojat e komuniteteve diasporike mund të ndërthuren, pa qenë domosdoshmërisht të njëjta në synime dhe në përmbajtje. Pikërisht kjo marrëdhënie ndërmjet vazhdimësisë së identitetit, institucionalizimit të arsimit dhe interesave politike të kohës përbën veçantinë e rastit të Borgo Erizzo-s dhe kontributin e tij në historinë e arsimit dhe të kulturës shqiptare.

Referencat

[1] Babić, Dragutin, dhe Šenol Selimović. "Zadarski Arbanasi: Sjećanje, etnički i nacionalni identitet." Anali Hrvatskog politološkog društva, vëll. 15, nr. 1 (2018).

[2] Barančić, Maximiljana. "Arbanasi i etnojezični identitet." Croatica et Slavica Iadertina, vëll. 4, nr. 4 (2008).

[3] Bartl, Peter, dhe Injac Zamputi. Vincenzo Zmajevich, Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë / Relazione dello stato d'Albania e Serbia (1702–1703). Redaktuar nga Albert Ramaj. Prishtinë–St. Gallen: Faik Konica–Albanisches Institut, 2022.

[4] Bello, Hasan. "Angazhimi i Austro-Hungarisë për librin e parë shqip të historisë së shqiptarëve". Telegrafi. https://telegrafi.com/angazhimi-austro-hungarise-per-librin-e-pare-ne-shqip-te-historise-se-shqiptareve/ (konsultuar më 1 nëntor 2026).

[5] Csaplár-Degovics, Krisztián. "A dalmáciai Borgo Erizzo és az albán nemzetépítés. Az Osztrák–Magyar Monarchia új Albánia-politikája, 1896." Világtörténet, vëll. 10 (42), nr. 2 (2020), f. 205–222.

[6] Csaplár-Degovics, Krisztián. "Austro-Hungarian Colonial Ventures: The Case of Albania." The Hungarian Historical Review, vëll. 11, nr. 2 (2022).

[7] Diklić, Mihovil. "Pojava i razvoj pravaštva u Arbanasima kod Zadra." Radovi Zavoda za povijesne znanosti HAZU u Zadru, nr. 48 (2006).

[8] Erber, Tullio. La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara. Cenni storici raccolti dai documenti dell'I. R. Archivio Luogotenenziale. Ragusa: G. Flori, 1883.

[9] Koliqi, Ernest. “Giacomo Vuxani, patriota Italo-albanese di Zara.” Shêjzat / Le Pleiadi, viti VIII, nr. 5–6 (maj–qershor 1964).
[10] Kovačec, August. “Arbanasi-Albanisch.” Në Lexikon der Sprachen des europäischen Ostens, redaktuar nga Miloš Okuka, f. 67–70. Klagenfurt: Wieser Verlag, 2002.
[11] Kraja, Bendis. “The Albanian Congress of Trieste, 1913: A Crossroad of Albanian National Aspirations on the International Stage.” Bulgarian Historical Review, vëll. 54, nr. 2 (2026), f. 104–131. DOI: 10.71069/BHR2.26.BK04.
[12] Krstić, Kruno. Rječnik govora zadarskih Arbanasa. Zadar: Mjesna zajednica Arbanasi, 1987.
[13] Malaj, Edmond. “Rrethanat politiko-shoqërore të shpërnguljes së shqiptarëve në Zarë dhe krijimi i kolonisë së Borgo Erizzo-s.” Studime Historike, nr. 1 (2024).
[14] Maserati, Ennio. Momenti della questione adriatica (1896–1914). Albania e Montenegro tra Austria ed Italia. Udine: Del Bianco, 1981.
[15] Meta, Beqir, dhe Sokol Gjermëni, përgatitës dhe redaktorë. Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912). Vëll. I, janar–mars. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Botimet Albanologjike, 2014.
[16] Muner, Paolo. “Jo vetëm ‘Hymni i Flamurit’. Disa kuriozitete mbi ‘himnet e tjera kombëtare’ shqiptare.”, Hylli i Dritës (Shkodër, 2013).
[17] Ramadani, Fehari. “Qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj lëvizjes kulturore shqiptare gjatë vitit 1910.” Studime, nr. 19 (2012), Prishtinë, 2013.
[18] Stipčević, Aleksandar. Tradicijska kultura zadarskih Arbanasa. Zagreb: Ibis grafika, 2011.
[19] Tocci, Terenzio. Diftime e vrime mi Kongres Shqyptaar t’Triestës 1–4 marcit 1913 / Resoconto e note sul Congresso Albanese di Trieste, 1–4 marzo 1913. Milano, 1913.
[20] Varisco, Giorgio, red. Borgo Erizzo. Scritti dedicati al quartiere albanese della città di Zara / Arbanasi. Napisi posvećeni albanskoj četvrti grada Zadra / Arbeneshi. Shkrimet kushtuar lagjes shqiptare në qytetin e Zarës. Atti e Memorie della Società Dalmata di Storia Patria, vëll. XLIV. Venezia: Società Dalmata di Storia Patria, 2022.
[21] Weigand, Gustav. “Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien.” Jahresbericht des Instituts für Rumänische Sprache, vëll. XVII–XVIII (1911), f. 177–239.
[22] Arkivi Shtetëror Austriak (Österreichisches Staatsarchiv), Vjenë
[23] Haus-, Hof- und Staatsarchiv (ÖStA/HHStA), Politisches Archiv, PA XIV, Albanien, Kt. 3, Liasse I, AT-OeStA/HHStA PA XIV 3, “Albanesische/albanische Sprachkurse in Borgo Erizzo, 1897–1906.”
[24] Arkivi i Institutit të Historisë (AIH), Tiranë
[25] AIH, Vj. 20-2-250, raport nr. 442/7, mars 1910.
[26] AIH, Vj. 20-I-161, njoftim nr. 3085, Vjenë, 21 nëntor 1910.
[27] Albania, revistë e drejtuar nga Faik Konica, Bruksel. Numrat që trajtojnë veprimtarinë e Borgo Erizzo-s, nga viti 1902.
[28] Il Dalmata, 10 mars 2023, paraqitje e vëllimit Borgo Erizzo, redaktuar nga Giorgio Varisco.
[29] L’Osservatore Triestino, njoftim mbi interpretimin e një himni shqiptar gjatë Kongresit të Triestes, mars 1913.